

GJYKATA E APELIT

Numri i lëndës: **PAKR 429/16**

Data: **20 dhe 27 tetor 2016**

Gjykata Themelore e Prishtinës: **PKR. nr. 357/14**

Gjykata e Apelit, në Kolegjin e përbërë nga Gjyqtari i EULEX-it Roman Raab, si Kryetar i trupit gjykues dhe si Gjyqtar Raportues, Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, Hava Haliti dhe Abdullah Ahmeti si anëtarë të Kolegjit, të ndihmuar nga Vjollca Kroci-Gërzhaliu, Këshilltare Ligjore e EULEX-it në Kosovë, duke vepruar në cilësinë e procesmbajtëses,

në lëndën penale në lidhje me të akuzuarin:

K. D., emri i babait xxx, mashkull, i lindur më xxx në xxx, me banim në rrugën "xxx", nr. xxx në xxx, xxx i Kosovës, shtetas i xxx, me numër të letërnjoftimit xxx;

I akuzuar me Aktakuzën PP. nr. 776-3 / 2012 të datës 25 qershor 2014 të Prokurorisë Speciale dhe e paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës Themelore të Prishtinës më 26 qershor 2014 për veprat penale të:

Rrezikimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare, në shkelje të nenit 141 (3) të ish Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK);

Dëmtimi i pasurisë së luajtshme, në shkelje të nenit 260 (2) të KPK-së;

I liruar nga akuzat me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës; PKR. nr. 357/14 të datës 18 shkurt 2016;

i arrestuar pas ankesës kundër aktgjykimit të lartpërmendur të parashtruar nga Prokurori Special më 05 prill 2016;

pas shqyrtimit të përgjigjes së avokatit mbrojtës Afrim Salihu të paraqitur më 8 prill 2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe të pranuar më 11 prill 2016 në Njësinë e Gjyqtarëve të EULEX-it;

pas shqyrtimit të Mocionit PPA / I. nr. 399/2016 të Prokurorit të Apelit të paraqitur në Gjykatën e Apelit më 26 gusht 2016;

pas këshillimit dhe votimit më 20 dhe 27 tetor 2016;

duke vepruar në bazë të nenit 390 (1), 394, 398 (1) pika 1.2, neni 401 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK),

nxjerr këtë:

AKTGJYKIM

- **Refuzohet si e Pabazuar Ankesa e Prokurorit Special e paraqitur më 05 Prill 2016 kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR. nr. 357/14 e datës 18 shkurt 2016,**
- **Vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të Prishtinës PKR. nr. 357/14 e datës 18 shkurt 2016.**

ARSYETIMI

I. HISTORIA PROCEDURALE

Aktakuza në këtë rast ishte paraqitur më 26 qershor 2014. Shqyrtimi gjyqësor filloi më 14 korrik 2015 në Gjykatën Themelore të Prishtinës. Seancat janë mbajtur më 15 dhe 16 korrik, 1, 2 dhe 14 shtator, 7 tetor dhe 9 nëntor 2015. Seancat janë mbajtur edhe më 28 janar dhe më 15 dhe 18 shkurt 2016.

Përshkrimi i hollësishëm i procedurës deri në shpalljen e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës është përshkruar në Aktgjykimin PKR. nr. 357/14 të datës 18 shkurt 2016;

Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore të Prishtinës; PKR. nr. 357/14 i datës 18 shkurt 2016 (në tekstin e mëtejshëm: Aktgjykimi i kundërshtuar), Prokurori Special paraqiti ankesë më 05 prill 2016. Avokati mbrojtës i të pandehurit paraqiti përgjigje në ankesë më 8 prill 2016 në Gjykatën Themelore të Prishtinës.

Rasti u transferua në Gjykatën e Apelit (në tekstin e mëtejshëm: GJA) për një vendim në lidhje me ankesën më 3 gusht 2016. Rasti iu është dërguar Prokurorisë së Apelit në të njëjtën ditë dhe e mori prapë lëndën me Mocionin e Prokurorit të Apelit në 26 gusht 2016.

Kolegji i Gjykatës së Apelit (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji) u këshillua dhe votoi më 20 dhe 27 tetor 2016.

A. Pranueshmëria e ankesës

Aktgjykimi iu ishte dorëzuar Prokurorit më 22 mars 2016, siç dokumentohet nga fletë-kthesa dhe ankesa ishte ngritur në 05 Prill 2016, siç dokumentohet me vulën e Gjykatës Themelore të Prishtinës. Prandaj, ankesa është parashtruar me kohë. Ankesa është gjithashtu e pranueshme pasi u parashtrua nga personi i autorizuar, në pajtim me nenin 380 (1) KPP.

II. PARASHTRESAT E PALËVE

A. Ankesa

PSRK-ja me apel konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, sipas nenit 383 (1) 1.3 dhe Nenit 386 (1) të KPP-së. Në ankesën e saj ajo ngre argumente të shumta ku thuhet se gjykata e shkallës së parë ka bërë një vërtetim të gabuar faktik të provave të identifikimit, të siguruara nga Xh.H., një ish-zyrtar policor. Prokurori special më tej thekson se gjykata e shkallës së parë bie në kundërshtim me konstatimin e vet në lidhje me kredibilitetin e Xh.H.t. Ajo thotë se aktgjykimi i Gjykatës Themelore përmban kontradikta dhe mospërputhje, prandaj ajo i propozon GJA-së që t'i vërtetojë dhe vlerësojë provat materiale dhe ta shpallë të pandehurin fajtor.

B. Përgjigjja e avokatit mbrojtës

Në përgjigjen e tij, avokati mbrojtës thotë se Aktgjykimi i kundërshtuar është i bazuar dhe i bazuar në ligj. Ai më tej thotë se aktakuza ishte e bazuar vetëm në provat indirekte dhe në një dëshmi të vetme të dhënë nga zyrtari policor. Ai kërkon nga GJA-ja që të vërtetojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe të hedh poshtë ankesën e Prokurorisë.

C. Mocioni i Prokurorit të Apelit

Prokurori i Apelit në mocionin e saj e mbështet plotësisht ankesën. Ajo vë në dukje se gjykata e shkallës së parë ka bërë disa gabime në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmitarit Xh.H. dhe vërtetimin e gjendjes faktike. Duke ngritur argumente të shumta, Prokurori i Apelit kërkon nga GJA-ja që të miratojë ankesën e paraqitur nga Prokurori Special i EULEX-it, ta anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe ta kthejë çështjen për rigjykim dhe vendosje.

D. Kompetencat e Kolegjit të EULEX-it të Gjykatës së Apelit

Kolegji i Gjykatës së Apelit është formuar në përputhje me nenin 19 (1) të Ligjit për Gjykatat dhe Nenit 3 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it - Ligji nr. 03 / L -053 i ndryshuar me ligjin nr. 04 / L-273, dhe i sqaruar nëpërmjet Marrëveshjes ndërmjet Shefit të EULEX-it dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës të datës 18 qershor 2014.

Ligji për ndryshimin nr. 04 / L-273 (i njohur edhe për publikun si Ligjit Omnibus i EULEX-it), në nenin 1.A përcakton se cilat raste përbëjnë raste në vazhdim, të cilat bien nën juridiksionin e EULEX-it. Rasti i tanishëm përbën qartësisht një rast në vazhdim sipas nenit 1A (1) të ligjit në fjalë. Hetimet në këtë rast ishin iniciuar në vitin 2012, aktgjykimi i shkallës së parë u lëshua më 18 shkurt 2016.

III. Konstatimet në lidhje me meritat

Me Aktgjykimin PKR nr. 357/14, Gjykata Themelore e Prishtinës e ka liruar të pandehurin **K.D.** nga të gjitha akuzat, siç përshkruhen në Aktakuzë.

PSRK-ja me anë të ankesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, në përputhje me nenin 383 (1) 1.3) në lidhje me nenin 386 (1) të KPP-së.

Gjykata e shkallës së parë e shpall të pandehurin të pafajshëm, sepse nuk ishte vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se i pandehuri **K.D.** kishte kryer veprat penale, për të cilat ai ishte akuzuar.

Kolegji i GJA-së konstaton se aktgjykimi i kundërshtuar është mjaftueshëm i arsyetuar. Aktgjykimi i kundërshtuar konstaton se polici Xh.H. nuk është dëshmitar i besueshëm. Siç thuhet në aktgjykimin e kundërshtuar dhe të evidentuar në shkresat e lëndës, Xh.H., së pari dha raport shumë të shkurtër në lidhje me incidentin më 4 shkurt 2012 dhe një deklaratë të hollësishme ia dha policisë franceze në shtator të vitit 2013. Në raportin e shkruar dhe në deklaratën e tij, ai thotë se tre persona e kanë sulmuar automjetin. Ai e ndryshon dëshminë e tij në shqyrtim gjyqësor, kur u dëgjua nga Kolegji. Ai në të vërtetë u dëgjua në lidhje me incidentin e 4 prillit të vitit 2012 në shqyrtimin gjyqësor më 1 shtator 2015, me anë të lidhjes me video. Sipas procesverbalit të seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 1 shtator 2015, ai deklaroi se "*e vërteta*" është se kanë qenë pesë persona duke hedhur gurë, por në raport ai deklaroi tre persona, pasi që atij i ishte thënë të shkruante ashtu. Fakti që ai ka pranuar se ai e ka shkruar raportin e pasaktë të incidentit, nuk e bën atë të besueshëm. Duke pasur parasysh funksionin zyrtar të dëshmitarit Xhevdet Haliti në këtë ngjarje, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se dëshmitari nuk është i besueshëm.

Gjykata e shkallës së parë i ka interpretuar në mënyrë korrekte provat në favor të të pandehurit, duke pasur parasysh gjendjen e dyshimit dhe pasigurisë së krijuar nga deklaratat e ndryshme dhe të ndryshueshme të dëshmitarit Xh.H.. Gjegjesisht, siç thuhet në nenin 3 të KPP- së '*Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen [...] interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.*'

Kolegji përkujton se vlerësimi i provave duhet të mbështetet në një shqyrtim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm të dëshmive gojore dhe deklaratave nga një Kolegj i gjyqtarëve. Ky nuk është vetëm parim praktik, por ky është gjithashtu i vendosur në mënyrë rigorozë nga ligji se "*Gjykata e bazon aktgjykimin vetëm në faktet dhe në provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor*" / *Neni 361 (1), KPP*. Për më tepër, "*Gjykata merr vendim në bazë të provave që shqyrtohen dhe verifikohen në shqyrtim gjyqësor*" *Neni 8 (2), KPP*. Prandaj, Kolegji pajtohet me gjetjet dhe vlerësimin e drejtë të këtij dëshmitari nga gjykata e shkallës së parë, si jo serioz dhe jo mjaft i besueshëm në bazë të cilit të gjendet dikush fajtor.

Në procesin e saj të nxjerrjes së aktgjykimit, gjykata duhet të jetë e bindur, pa asnjë hezitim se gjykimi është i drejtë dhe i bazuar në prova. Deklaratat e ndryshme të dëshmitarit Xh.H. nuk mund të shërbejnë si burim i çiltër për të bazuar aktgjykimin e fajësisë. Në të njëjtën kohë asnjë provë tjetër nuk mund ta lidhë përfundimisht të pandehurin për veprat penale në fjalë ose të bëjë gjykatën që të vendosë ndryshe. Pjesëmarrja e të pandehurit nuk është vërtetuar përfundimisht,

prandaj pjesëmarrja e tij në veprat penale, për të cilat akuzohet, nuk është vërtetuar. Asnjë nga dëshmitarët e besueshëm nuk dëshmoi pozitivisht për pjesëmarrjen e të pandehurit në ngjarjen, siç përshkruhet në aktakuzë.

Kolegji tërësisht i ka shqyrtuar gjetjet faktike në aktgjykimin e shkallës së parë (versioni në gjuhën angleze) dhe pajtohet plotësisht me gjetjet. Sipas mendimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë vjen në konkluzione logjike në vlerësimin e provave.

Për arsyet e parashtruara, Kolegji i GJA-së hedh poshtë pretendimin e Prokurorisë në ankesën e saj dhe konfirmon aktgjykimin e Gjykatës Themelore të Prishtinës, siç parashikohet në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

IV. Çështjet sipas detyrës zyrtare

Kolegji i Gjykatës së Apelit, edhe pse nuk është një objekt i dispozitivit të këtij aktgjykimi, duhet të ketë parasysh çështjen e veprës penale të Dëmtimit të pronës së luajtshme, sipas nenit 260 (2) të KPK-së. Domethënë, kjo veprë penale ka arritur parashkrimin. Në pajtim me nenin 91 të KPK-së, afati i parashkrimit në lidhje me ndjekjen penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. Vepra penale ka ndodhur më 4 prill 2012. Dënimi për këtë veprë penale është deri në një vit burgim, siç përcaktohet në nenin 260 (2) të KPK-së. Prandaj, në pajtim me nenin 90 paragrafi (1), 6) të KPK-së, afati i parashkrimit për këtë veprë penale është dy vjet. Për më tepër, ligji përcakton ndalesën absolute për ndjekjen penale, që do të thotë se pavarësisht nga veprimet e autoriteteve, prokuroria është e ndaluar pas asaj periudhe kohore: Neni 91 paragrafi (6) i KPK-së përcakton se: "*Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).*"

Pasi që vepra penale është kryer më 4 prill 2012, ndalesa absolute mbi ndjekjen penale është arritur më 4 prill 2016, tashmë para se GJA-ja ta pranonte më 3 gusht 2016.

Prandaj, parashkrimi absolut për ndjekje penale kundër të akuzuarit **K. D.** në lidhje me akuzën e Dëmtimit të pronës së luajtshme, nga neni 260 paragrafi (2) i KPK-së ishte arritur para datës që Kolegji i Apelit të diskutonte në lidhje me këtë rast.

Siç u tha më lart, në bazë të nenit 401 të KPP-së, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv.

Aktgjykimi është përpiluar në gjuhën angleze.

Kryetari i trupit gjykues dhe Gjyqtari raportues

Roman Raab, Gjyqtar i EULEX-it

Anëtarët e Kolegjit

Hava Haliti, Gjyqtare vendore e GJA-së

Abdullah Ahmeti, Gjyqtar vendor i GJA-së

Procesmbajtëse

Vjollca Gërxhaliu-Kroçi, Këshilltare Ligjore e EULEX-it